

VENDIM
Nr. 41, datë 7.4.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “EURON ENERGY
GROUP” SHPK, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERVE TË
ERE-S NR. 87, DATË 26.9.2011, TEK SHOQËRITË “ALB-ENERGY” SHPK, “EURON
ENERGY” SHPK DHE “ENERGAL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 7, nenit 149 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar; si dhe nenit 4, nenit 17 pika 1, pika 3, 4 dhe pika 5, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 87, datë 26.9.2011 të Bordit të Komisionerve të ERE-s për miratimin e transferimit të licencës së prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. tek shoqëritë “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga dokumentacioni i paraqitur në ERE nga shoqëritë “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., sipas nenit 17 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton:

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k.,

Neni 17, pika 4 germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa b : Informacioni, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: vendimin me shkrim në organet drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës, plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Alb-Energy ” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: I plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa a: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: I plotësuar në mënyrë korrekte.

Shoqëria “ENERGAL” sh.p.k.,

Neni 17, pika 2 germa “a”: Format i aplikimit sipas neni 9, pika 1 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2 plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 (shoqëria “Energal” sh.p.k., është shoqëri e sapokrijuar); germa “d”: plotësuar në mënyrë korrekte.

Meqenëse licenca e tregtimit nuk mund të transferohet njëkohësisht në tre subjekte të ndryshme, do të komunikohet me shoqëritë e mësipërme që licenca e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. t’i transferohet vetëm njërit nga subjektet, apo secili nga subjektet “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k. që do të aplikojë në ERE për pajisjen me licencë tregtimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k.

2. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, tek shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.

3. Fillimin e procedurave për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 87, datë 26.09.2011, tek shoqëria “Energal” sh.p.k.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” dhe “Energal” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti